

Prirja e Racionalizimit të Ligjeve të Sheri'atit

Sejjid Muhammed Rizvi

"Përse duhet të falemi pesë herë në ditë? Përse qentë dhe derrat konsiderohen të papastër (*nexhis*)? Përse një kafshë e therur në mënyrë joislame është e ndaluar (*haram*) dhe e ndytë?" Këto janë vetëm disa nga pyetjet e shumta që shtrohen nga të rinjtë, mbi ligjet e Sheri'atit. Ata duan ta "racionalizojnë" çdo ligj të Sheri'atit; ata dëshirojnë të dinë arsyen dhe qëllimin e ligjërimit të gjykimeve të tilla. Përpara se të shpjegohet vlefshmëria ose jo e "racionalizimit" të Sheri'atit, duket i nevojshëm qartësimi i qëndrimit themelor të një muslimani ndaj Sher'iatit.

Islami është një *din* – fe. *Din* do të thotë sistem i plotë jete, që përbëhet nga bindje dhe ligje. Për të njohur qëndrimin islam ndaj ligjeve të Sheri'atit, duhet studiuar Kur'ani dhe Hadithi. Në Kur'an e Hadith gjenden dy qëndrime të ndryshme ndaj dy aspekteve të ndryshme të fesë. Këto dy aspekte të fesë janë: a) bindjet themelore, të njohura si *usul ed-din* (rrënjët e fesë); b) ligjet e Sheri'atit, të njohura përgjithësisht si *furu' ed-din* (degët e fesë).

Lidhur me "rrënjët e fesë", Islami pret që muslimanët të besojnë në çështjet themelore të fesë së tyre pasi të kenë arritur bindje për vërtetësinë e tyre nëpërmjet hulumtimit dhe përsiatjes. Kur'ani i qorton shumë qartë ata që ndjekin të tjerët në çështje besimi:

{Nuk ka shtrëngim në fe, s'ka dyshim se rruga e drejtë është dalluar qartë nga e shtrembra} (2:256). Kur'ani pohon sërish: *{E kur u thuhet atyre: 'Ejani tek ajo që ka zbritur Allahu, dhe (te) i Dërguari' ata thonë: 'Na mjafton ajo në të cilëm i gjetëm paraardhësit tanë.' Si kështu?! Edhe pse paraardhësit e tyre s'kishin dije për asgjë e as nuk ishin të udhëzuar?}* (5:104). Ky dënim i fuqishëm i idhujtarëve përsëritet gjetiu me fjalët: *{dhe kur u thuhet: 'Ndiqni atë që ka zbritur Allahu', ata përgjigjen, "Jo, por ne ndjekim ato në të cilat i kemi gjetur paraardhësit tanë}* (2:170, 31:21). Islami pohon se njeriu mund t'i shqyrtojë pikëpamjet dhe qëndrimet e të tjerëve, por ai duhet të pranojë vetëm atë që është e arsyeshme të besohet: *{Ndaj, jepja sihariqet e mira shërbëtorëve të Mi që e dëgjojnë fjalën dhe ndjekin më të mirën presj saj. Ata janë që Allahu i ka udhëzuar e ata janë të mençurit}* (39:17)

Po kështu, në librat e haditheve shohim se i Dërguari i Allahut (s) dhe Imamët e Ehl ul-Bejtit përdornin argumente intelektuale në çështjet e besimit për t'i bindur kundërshtarët e tyre dhe kërkuesit e së vërtetës. Ky përbën në vetvete një shembull dhe traditë për muslimanët, që t'i mbështesin besimet e tyre mbi të kuptuarit dhe bindjen. Mirëpo, kur është fjala për "degët e fesë", Islami pret bindje absolute nga muslimanët. Arsyeja e kësaj pritshmërie është mjaft e qartë: me të besuar me vullnetin e tij të lirë në Allahun si Krijuesin dhe Vënesin e Urtë të ligjeve e në Muhammedin (s) si të Dërguarin e pagabueshëm të Allahut, dhe në Kur'anin si fjalën e Allahut, muslimani duhet - për rrjedhojë logjike - t'i përmbahet Sheri'atit. Ky nënshtrim absolut i lidhur me Sheri'atin mund të nxirret nga ajetet:

{Asnjë besimtar apo besimtareje nuk i takon që kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin një çështje, të bëjnë në të ndonjë zgjedhje të tyre. E kush nuk i bindet Allahut e të Dërguarit të Tij, ai padyshim është shmangur shumë nga e Vërteta} (33:36) {O ju që keni besuar! Mos i dilni përpara Allahut dhe të Dërguarit [në çështjet e fesë] dhe frikësojuni Allahut; s'ka dyshim se Allahu është Dëgjues, Njohës} (49:1) {O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe atyre në autoritet mbi ju (Imamëve)} (4:59) {Nuk kemi dërguar asnjë profet veçse që njerëzit t'i bindeshin} (4:64)

Për të përmbledhur: në bindjet islame, muslimanit i kërkohet të besojë vetëm pasi të jetë thelluar, kurse në ligjet islame prej tij pritet që t'u besojë pa rezerva.

Tani, le t'i kthehemi çështjes se përse është ligjësuar një ligj i caktuar i Sheri'atit. Nga pikëpamja e arsyeve dhe qëllimeve të ligjeve, Sheri'ati mund të ndahet në katër kategori:

1. Ligjet me arsye dhe qëllime të vetëkuptueshme, si psh: të ndihmuarit e nevojtarëve është shumë i këshillueshëm (*mustehab*), vrasja është e ndaluar (*haram*), pagimi i taksave si khumsi dhe zekati është i detyrueshëm (*waxhib*). Nuk nevojitet përgatitje prej eksperti apo intelekt i jashtëzakonshëm për të ditur se të ndihmuarit e nevojtarëve është gjë e mirë, se pagimi i taksave është i domosdoshëm për ruajtjen e barazpeshës financiare në shoqëri, apo se vrasja e gënjeshtër janë të këqija.

2. Ligjet që i kanë arsyet dhe qëllimet të shpjeguara në Kur'an e Hadith, si për shembull se pijet alkoolike janë të ndaluara, se kamata është e ndaluar, se agjërimi i muajit të Ramazanit është i detyrueshëm e po kështu edhe namazi.

Kur'ani dhe Hadithi kanë treguar se pija është një nga shkaqet kryesore të së keqes sepse një njeri i dehur nuk e kontrollon vetveten. Megjithëse botës iu desh një kohë e gjatë dhe përvojë e hidhur për ta kuptuar aspektin negativ të dehjes, Islami ia deklaroi dëmin dhe të keqen katërbëdhjetë shekuj më parë, duke thënë që {mëkati i saj është më i madh se përfitimi} (2:219)

Kamata ndalohet. Kur'ani dhe Hadithi e kanë shpjeguar dëmin e kamatës. Ajo shpie në shkatërrimin e pjesës së varfër të shoqërisë dhe e tërë pasuria rëndon drejt të kamurve.[\[1\]](#)

Agjërimi është përgatitje shpirtërore dhe trupore që i afron më shumë shërbëtorët te Allahu dhe i bën më të bindur ndaj Sheri'atit.

Namazi është mjet i shprehjes së mirënjohjes sonë ndaj Allahut: {O ju që besoni! Hani nga mirësitë që ju kemi siguruar dhe falënderojeni Allahun} (2:172). Ajo përbën një mënyrë të rëndësishme për të arritur qetësinë shpirtërore: {vërtet, me të kujtuarit e Allahut qetësohen zemrat} (13:28); dhe ai është gjithashtu metodë shumë efektive për ta bërë besimtarin edhe më të bindur ndaj ligjeve të Allahut: {s'ka dyshim se namazi mban larg prej të shëmtuarës dhe së ligës} (29:45).

Ekzistojnë shumë hadithe të Imamëve tanë, që shpjegojnë arsyet dhe qëllimet e shumë ligjeve të Sheri'atit. Dijetari i famshëm imami Shejh es-Saduk ka mbleshur shumë prej tyre në veprën e tij *'Ilal-u Shera'i*.

3. Ligjet të cilave nuk u janë shpjeguar arsyet dhe qëllimet në Kur'an ose Hadith, por të cilave horizontet në zgjerim të dijes njerëzore kanë ndihmuar t'ua kuptojmë synimin dhe dobinë e tyre: për shembull, përse ndalohet mish i derrit; përse rrethprerja këshillohet shumë nga Sheri'ati, si dhe përse vetëm peshqit me luspa lejohen të konsumohen në Islam.[\[2\]](#)

Për dobinë e rrethprerjes, po citojmë Sherman Silber-in, që thotë se: "Ka një sërë arsyesh përse rrethprerja është dobiprurëse dhe pse duhet kryer më mirë në fëmijëri. Së pari, ... ndalon kancerin e penisit në jetën e mëvonshme ... Kanceri i penisit ndodh zakonisht kur s'është treguar kujdes i nevojshëm për lafshën ... Një tjetër dobi e rrethprerjes është se gratë e burrave rrethprerë kaplohen më rrallë nga kanceri cervikal (i mitrës) ... Dobia më e drejtpërdrejtë e rrethprerjes është se ajo parandalon akumulimin e vajërave dhe sekrecioneve (të quajtura *smegma*) nën lafshë, të cilat shpiejnë në infektim, fryrje dhe nganjëherë kontraktim të lafshës, duke bërë që maja e penisit të mbesë e mbyllur."[\[3\]](#)

Për peshqit, është thënë se ato pa luspa janë të dëmshme për njerëzit. Mbështetur në kërkimet shkencore, trupat amerikane në lindje ishin porositur se "peshqit pa luspa të detërave tropikale është më mirë të lihen."

Duhet përmendur këtu se arsyet e Sheri'atit që janë zbuluar nga dituria njerëzore nuk mund të konsiderohen si arsyeja e vërtetë, përfundimtare (*ratio legis*) për ligjërimitin e atyre ligjeve, sepse dija njerëzore është akoma në djepin e saj kurse Islami, sheri'ati përfundimtar i Zotit do të mbetet në fuqi deri në fund të botës. Megjithatë, faktet shkencore mund të përdoren për të shpjeguar dobinë dhe të mirat që vijnë nga ligjet e Sheri'atit.

4. Ligjet, arsyet dhe qëllimet e të cilave nuk janë shpjeguar as në Kur'an dhe Hadith e që as përparimi i dijes njerëzore nuk ka mundur t'i shpjegojë: psh përse katër rekate në drekë, pasdite dhe darkë, ndërkohë që vetëm tre në muzg dhe dy në agim.

Sa u përket tre llojeve të para të ligjeve, nuk ka ndonjë problem të madh për t'ua shpjeguar arsyet dhe synimet. Problemi shfaqet kur fillojmë të racionalizojmë ligjet që kanë ardhur në kategorinë e katërt.

Lidhur me ligjet e kësaj kategorie, e vetmja gjë që mund të thuhet është se muslimani duhet të ketë besim të plotë që ekzistojnë patjetër qëllime të dobishme në këto ligje. Qëllimi i tyre mund të jetë material, shpirtëror, ose që të dyja. Përse duhet të kemi një besim të tillë në ligjet e Sheri'atit? Sepse ne, ndjekësit e dymbëdhjetë Imamëve pas Pejgamberit (s) besojmë që veprimet e Allahut kanë synim dhe se ato janë në dobi të qenieve njerëzore; e kjo përfshin edhe ligjet e Sheri'atit.[\[4\]](#) Mbi bazën e kësaj bindjeje, duhet të kemi besim të plotë se të gjitha ligjet e Tij (përfshi ato të cilave s'ua dimë akoma synimin) kanë synim dhe dobi prë qeniet njerëzore.

Këtu mbetet për t'u sqaruar edhe një pikë tjetër: nuk është përgjegjësi e dijetarëve islamë që të zbulojnë qëllimin dhe arsyen e ligjeve të Sheri'atit. Detyra e tyre parësore është shpjegimi i ligjeve të Sheri'atit. Përgjegjës për zbulimin dhe shpjegimin e qëllimeve të ligjeve të Sheri'atit janë intelektualët muslimanë që janë ekspertë të shkencave moderne. Fatkeqësisht, shumë pak prej tyre janë të interesuar në këtë aspekt të Sheri'atit, kurse të interesuarve prej tyre u mungon njohja e Kur'anit dhe Hadithit.

Besimi që, edhe pse mund të mos ia dimë arsyen ose qëllimin një ligji të caktuar të Sheri'atit, ai duhet ta ketë një arsye të mirë dhe synim të dobishëm, mund të kuptohet nga ky episod i Kur'anit, i cili tregon se po të na tregohet arsyeja e vërtetë e tij, ne do ta prananim menjëherë se ajo ishte gjëja e duhur për t'u kryer.

Teksa po i predikonte popullit të vet një ditë, Pejgamberi Musa (paqe pastë mbi të) mendoi se Allahu i kishte dhënë privilegj të madh dhe se ai ishte më i dituri i njerëzimit. Allahu nuk ishte i kënaqur madje as me një shenjë aq të vogël krenarie në mendjen e Musait, ndaj Xhibra'ili u dërgua që ta njoftonte Musain se në mesin e shërbëtorëve të Allahut kishte një person më të ditur se ai. Bashkë me njërin prej ndjekësve të tij, Musai shkoi ta takonte njeriun e ditur, që në hadithet tona mban emrin Khidr. Kur'ani tregon hollësitë e takimit të tyre:

60. (përkujto) Kur Musai djaloshit që e shoqëronte i tha: "Nuk do të ndalem së ecuri deri të arrijë vendtakimin e e dy deteve, ose do të udhëtoj një kohë të gjatë.

61. Kur arritën ata të dy vendtakimin e atyre deteve, e harruan peshkun e tyre, e ai (peshku) mori rrugën e vet si (strofull) në det.

62. Pasi e kaluan atë vend, ai (Musai) i tha djaloshit: "Na jep sillën tonë (ushqimin), meqë nga ky udhëtim jemi lodhur".

63. Ai (djaloshi - Jusha' bin Nun) tha: "A e sheh!?" Kur u strehuam te shkëmbi, unë e harrova peshkun dhe përveç djallit, nuk më bëri kush ta harroj që të ta kujtoj, dhe ai në mënyrë të çuditshme mori rrugën për në det!

64. Ai (Musai) tha: "Ai është (vendi) që ne po e kërkojmë!" Dhe u kthyen që të dy rrugës së tyre prej nga kishin ardhur.

65. Dhe e gjetën një robë Tanë, të cilit i kemi dhuruar mëshirë nga ana e Jonë dhe e kemi mësuar me një dituri të posaçme nga Ne.

66. Atij (Khidrit) Musai i tha: "A pranon të vij me ty, që të më mësosh nga ajo që je i dhuntisur ti: dituri të drejtë e të vërtetë?"

67. Ai (Khidri) tha: "Sigurisht, ti nuk do të mund të kesh durim me mua!

68. Si do të durosh për atë që nuk je i njoftuar?"

69. (Musai) Tha: "Në dashtë Allahu, do të shohësh se do të jem i durueshëm dhe nuk do të kundërshtoj ty asgjë!"

70. Ai i tha: "Nëse më shoqëron ti mua, atëherë mos më pyet për asgjë, derisa unë vetë të të tregoj për të".

71. E ata të dy shkuan deri kur hipën në anije, ai (i dishmi) e shqeu atë. Ai (Musai) tha: "A e shqeve që t'i fundosësh udhëtarët e saj, vërtet bërë një punë të hatashme?"

72. Tha: "A nuk të thashë se nuk do të mund të kesh durim me mua?"

73. (Musai) Tha: "Mos më qorto për se harrova dhe më mundo me vështirësi në këtë shoqërim timin (lehtësoma punën)!"

74. Vazhduan të shkojnë deri kur e takuan një djalë të ri, e ai (i dijsmi) e mbyti atë. (Musai) Tha: "A e mbyte njeriun e pastër, pa mbytë ai askë?! Vërtet ke bërë një punë të shëmtuar!"

75. (Khidri) tha: "A nuk të thashë se vërtet ti nuk do të mund të kesh durim me mua?"

76. (Musai) Tha: "Nëse pas kësaj të pyes (të kundërshtoj) për ndonjë gjë, atëherë mos më lejo të shoqëroj. Tashmë ndaj meje ke arsyetim (të mos më shoqërosh)!"

77. Vazhduan të shkojnë deri arritën te banorët e një qyteti që prej tyre kërkuan t'u japin ushqim, po ata nuk deshën t'i pranojnë si mysafirë (e as t'i ushqejnë) e ata të dy gjetën një mur që gati rrëzohej, e ai e drejtoi (murin). (Musai) Tha: "Sikur të kishe dashur do t'u merrje shpërblim për këtë!"

78. Ai (i dijsmi) tha: "Tash ka ardhur koha e ndarjes mes meje e teje, e unë do të tregoj për domethënien e asaj që nuk mund të keshë durim!"

79. Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e të varfërve, që veprojnë në det, e unë desha të bëjë atë me të meta, ngas para tyre ishte një sundues që grabiste çdo anije (të aftë - pa të meta).

80. Sa i përket djaloshit, dy prindërit e tij ishin besimtarë, e u frikësuam se ai do t'i shpie ata të dy në humbje e në mosbesim.

81. Deshëm që Zoti t'u japë në vend të tij një më të mirë se ai dhe më të afërt në respekt dhe në mëshirë (ndaj prindërve).

82. Përsa i përket murit, ai ishte i dy djelmoshave jetimë të atij qyteti, e nën të ata kishin një thesar (ari) dhe babai i tyre ka qenë njeri i mirë, e Zoti yt dëshiroi që ata dy (jetimë) ta arrijnë pjekurinë e vet dhe ta nxjerrin ata vetë thesarin e tyre. Kjo ishte mëshirë e Zotit tënd (ndaj tyre). Dhe unë nuk e pranova tërë atë sipas bindjes sime (por sipas udhëzimit Hyjnor). Ky, pra, është sqarimi i asaj për të cilën nuk bërë dot durim! (18:60-82).

Nëse një Pejgamber i madh i Allahut si Musai ('a) nuk mund ta kuptonte domethënien e veprimeve të një njeriu si ai që ishte më i ditur, si mund të presim ne ta dimë urtinë dhe qëllimin e çdo ligji të legjisluar nga Allahu i Urtë, i Gjithdijshmi Fuqplotë!

Referencat:

[1] Për një diskutim të hollësishëm të kamatës, të shihet 'Allamah Tabataba'i's *al-Mizan* (translated by S.S.A. Rizvi), vol. I, Wofis, Tehran 1982, ff. 295-303.

[2] Për një diskutim të hollësishëm të derrit, të shihet *Pork* nga S.S. A. Rizvi, Wofis, P.O. Box 2245, Tehran.

[3] Sherman Silber, *The Male*. New York, 1981, ff. 115-6.

[4] 'Allamah Hilli, *al-Babu 'l-hadi 'ashar*, (translated by W.M. Miller), Luzac, London 1958, ff. 45-6.

Terma të Përgjithshëm

Waxhib – e detyrueshme, obligim, detyrë, e domosdoshme. Një veprim që duhet kryer patjetër, për kryerjen e të cilit muslimani shpërblehet dhe për moskryerjen e të cilit ai/ajo dënohet, si psh namazi, agjërimi etj.

Ihtijat waxhib – detyrë për nga kujdesi. Domethënia e saj është si ajo e waxhibit, me ndryshimin se në çështjet ku mexhtehidi thotë ihtijat waxhib, kemi mundësinë të mob bëjmë *teklid* të atij muxhtehidi, por të ndjekim mendimin e muxhtehidit tjetër më të mirë në atë problem.

Haram – e ndaluar rreptësisht. Është e domosdoshmë të përmbahemi nga veprimet haram, kryerja e të cilave do të sjellë dënim. Veprim haram psh është ngrënia e derrit.

Sunnet, Mustehab – e këshillueshme, e dëshirueshme, e rekomandueshme. Veprime, moskryerja e të cilave nuk dënohet, por kryerja e të cilave shpërblehet, si psh thirrja e ezanit.

Mekruh – e papëlqyeshme, e qortueshme. Këto janë veprime kryerja e të cilave nuk dënohet, por shmangia e të cilave shpërblehet, si psh të ngrënit në gjendje xhunub.

Xha'iz, Hallall, Mubah – e lejuar, e ligjshme. Veprime ose gjëra që janë të lejuara dhe të ligjshme. Nuk ka shpërblim për kryerjen e tyre e as dënim për neglizhimin e tyre, si psh pirja e çajit. Mubah përdoret ekskluzivisht për gjërat e lejuara e jo për veprime e lejuara.